



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE BASHKIAKE MAT

NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më _____.____.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E THJESHTUAR – SHËRBIME”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të automjeteve”, – Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34330000-9 – Pjesë këmbimi për automjete , furgonë dhe makina transporti mallrash.

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 100 000 (shtatë milion e njëqind mijë) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin 2024 në vlerën: 3 549 999.99 (tre milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**: nga grandit: 3 263 333.33 (tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 286 666.66 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: 3 550 000.01 (tre milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë pikë zero një) **lekë pa TVSH**: nga grandit: 3 263 333.34 (tre milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 286 666.67 dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/ enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/ Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021**, dhe **2022** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021**, dhe **2022**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 9 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.**

3. **Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.**

Në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, **duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.** Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë **40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.**”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë në një vlerë, jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, vlerë kjo e kërkuar brenda masës së përcaktuar në dispozitat nënligjore të sipërcituara, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujtuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj marrëveshje kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c dhe 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**;... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në **nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 3** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”

Ndërsa në **nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: **b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kriteret për shërbime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 41 që provon kryerjen e shërbimeve të ngjashme në masën e përcaktuar në pikën 4/b të nenit 55.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një numër minimal prej 4 (*katër*) punonjësish të punësuar, të cilët duhet të rezultojnë në listëpagesa për periudhën **3 (tre) muajt e fundit**. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar pjesë të stafit punonjës minimumi 1 (një) punonjës me specialitetin: Inxh.mekatronikë dhe 2 (dy) punonjës me specialitetin mekanik të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë (*përfshijmë kur figuron si sipërmarrës, administrator etj.*) për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.2.

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, *si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacion:

- Çertifikatat e Kualifikimit/Diplomë (*mekanik dhe Inxh.mekatronikë*)
- Kontratat Individuale pune (*të vlefshme*)

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës me qëllim kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, duhet të disponojë 1 (*një*) servis automjetesh në pronësi ose me qera, me një sipërfaqe jo më të vogël se 50 m² (*për 3 pozicione*), ku për vërtetimin e përmbushjes së këtij kushti, duhet të paraqesë:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*dhe kontratën noteriale të qirasë me kohëzgjatje në përputhje me afatin e M. Kuadër, në rast se servisi është me qira*)
- Leje nga QKL, (Kodi III.1.A) – *Pikë servisi*
- Foto në plane të ndryshme (*të paktën 2*)

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës në servisin e kërkuar në pikën 2.3.4, duhet të ketë të instaluar minimumi 3 (tre) vinç - urë ngritëse, me peshëmbajtje jo më pak se 3 (*tre*) ton, minimumi 1 (një)

grupë kontrolli në një gjatësi të paktën mbi 5 (*pesë*) m, si dhe duhet të disponojë pajisje për ç'montim/ montim gomash të automjeteve të rënda, ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten nga 2 (*dy*) foto për secilën pajisje në plane të ndryshme.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë në pronësi, huapërdorje ose me qira 1 (një) automjet karrotrec, me qëllim kryerjen e shërbimit të transportit të automjeteve objekt kontrate. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të automjetit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 9 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose kontrata e shitblerjes; ose kontrata e dhurimit; ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë Noteriale Huapërdorje (*me kohëzgjatje në përputhje me afatin e M. Kuadër*)

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë Noteriale Qiraje (*me kohëzgjatje në përputhje me afatin e M. Kuadër*)

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Liçencën për transport mallrash brenda vendit (*e vlefshme*)

f) Foto e dukshme të mjetit bashkë me targat (*të paktën 2*).

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit** për mjetet nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se, do të lejojë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), që të verifikojnë pajisjet që ka të instaluar në servis in e deklaruar, nëse nga ana e KVO-së, do të kërkohet një verifikim i tillë gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare **dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.** Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 41 “Kërkesat të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4 dhe 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kriteret detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e numërit minimal prej 4 (*katër*) punonjësish, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 41 pika 4/b, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, autoriteti kontraktor ka marrë parasysh numrin e personelit që nevojitet për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve teknike” dhe shërbimeve që kërkohen në Shtojcën 6 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit” përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, dhe ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet

formës elektronike”, si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkret që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

2. Bazuar në shërbimet që kërkohen të kryhen, përcaktuar në preventin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vlerëson të domosdoeshëm kërkesën që, operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën personelin kryesor i cili të ketë njohuritë e duhura për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate që kërkohen, i cili duhet të disponojë të paktën punonjësit me specialitetin: **Inxh.Mekatronikë** dhe **mekanik**. Njësia e prokurimit vlerëson se operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet që t’i ketë deklaruar këto punonjës në listëpagesat e kërkuara sipas kodit të funksionit që kanë, në zbatim kjo me parashikimet e pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.514, datë 20.09.2017 “*Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar*” ku me qëllim të vërtetimit se këto punonjës janë të kualifikuar/ kanë njohuri për specialitet e deklaruar, Op. Ek. Pjesëmarrës duhet që të paraqesë dhe dokumentacionin vërtetues: diplomë/dëshminë/ certifikatën për aftësitë e secilit punonjës.
3. Referuar natyrës dhe përmasave të shërbimeve objekt prokurimi, me qëllim kryerjen e tyre, lind e domosdoeshme që Operatori Ekonomik pjesëmarrës të disponojë një servis automjetesh me përmasat e kërkuara, ku për vërtetimin e disponimit të tij, Op. Ek., duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë, kontratën noteriale të qirasë në përputhje me afatin e marrëveshjes kuadër, lejen përkatëse nga QKL për ushtrimin e pikës së servisit në zbatim të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*” si dhe fotot të planeve të ndryshme të servisit të deklaruar.
4. Po ashtu, referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson të domosdoeshme kërkesën që operatorët ekonomik pjesëmarrës për vërtetimin se janë të aftë të zbatojnë kontratën/ kontratat objekt prokurimi, duhet patjetër që të disponojnë pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve si: minimumi 3 (*tre*) vinç - urë ngritëse, me peshëmbajtje jo më pak se 3 (*tre*) ton, minimumi 1 (*një*) gropë kontrolli në një gjatësi të paktën mbi 5 (*pesë*) m, si dhe të disponojnë pajisje për ç’montim/ montim gomash të automjeteve të rënda, pasi pa këto pajisje njësia e prokurimit gjykon se, një Op. Ek. nuk mund të realizojë shërbimet objekt prokurimi që kërkohen të kryhen.
5. Gjithashtu, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të disponojnë në pronësi, huapërdorje ose me qira 1 (*një*) automjet karrotrec, me qëllim kryerjen e shërbimit të transportit të automjeteve objekt kontrate, pasi referuar vetë natyrës së kontratës, disponimi i një karrotreci është i domosdoeshëm, ku mund të kemi raste ku defekti i mjeteve dhe automjeteve mund të ndodhë gjatë kohës, kur këto janë në punë, në vendodhje të ndryshme brenda territorit të Bashkisë Mat, dhe se A.K. do të duhej që të paguante kosto shtesë për transportin e tyre drejt vendndodhjes së servisit të kontraktuesit, ku për këtë arsye, vlerësohet e domosdoeshme kërkesa që Op. Ek. pjesëmarrës duhet që të disponojë minimumi një

karrotrec, si dhe po ashtu njësia e prokurimit në pikën 2.3.7 të Kapaciteteve teknike, kërkon që Op. Ek. të deklarojë dhe se merr përsipër kryerjen e shërbimit të transportit të mjeteve, për të përjashtuar mundësinë që kontraktuesi të pretendojë se një shërbim i tillë nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit për këtë prokurim. Për vërtetimin e disponimit të tij duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë ose të marrjes me qira të mjetit, si dhe dokumentacionin sipas legjislacionin në fuqi për lejimin e qarkullimit të mjeteve.

6. Me qëllim që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të ketë mundësinë që të kryejë verifikimet e nevojshme gjatë vlerësimit teknik të ofertave, për shmangien e pasigurisë në vlerësim, njësia e prokurimit vlerëson që t'u kërkojë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që të deklarojnë se janë dakort për të lejuar anëtarët e KVO-së që të verifikojnë pajisjet e instaluar në servis dhe deklaruar, nëse një gjë e tillë kërkohet nga KVO-ja. Kjo kërkesë e njësive nuk përbën kosto shtesë për Op. Ek. pjesëmarrës, si dhe përjashton mundësinë që këto të fundit, për arsye të ndryshme të mos lejojnë hyrjen në servis të anëtarëve të KVO-s, ku si rrjedhojë do të sillte mosvlerësimin korrekt/ në mënyrë të drejtë të ofertave.

Kapacitetet dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të shërbimeve dhe mallrave/ pjesëve të këmbimit objekt prokurimi, bazuar në specifikimet teknike të dërguara nga Sektori i Rrugëve Rurale/ Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake Mat, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** "Për Prokurimin publik¹", dhe nenit 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

- **Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- **Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**
- **Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë data 15.03.2024, ora 10.⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT